



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2020:050103

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06005694

C.nr.41/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarën Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, Rr.” L. e P.”, Magjistrалja Prishtinë – Fushë Kosovë Pa nr., të cilën e përfaqëson me autorizim Kosovo D. C. A. Sh.P.K. nga i autorizuari i saj V. H., kundër të paditurit H. R. nga fsh..., Komuna e Dragashit, për rimbursimin të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 3,219.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me dt. 24.06.2024 mori, ndërsa me datë 31.07.2024 përpiloi edhe këtë:**

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri H. (Sh.) R. nga fsh. ... - Komuna e Dragashit, që paditëses Byros Kosovare të Sigurimit t'i rimbursoj shumën prej 3,219.00 euro (tremijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë euro), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 03.09.2017 në Dragash dhe atë me kamat ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, me datën 23.04.2020, ka paraqitur padi për rimbursimin e demit material dhe jo material në shumë prej 3,219,00 €, kundër të paditurit H. (Sh.) R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, ku ka theksuar se i padituri me datën 03.09.2017, në fshatin Z., duke drejtuar automjetin Ford E. me targa..., pronë e tij dhe në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese respektivishtë me afat të skaduar të policës së sigurimit, ka shkaktuar aksident trafiku, në atë mënyrë që kur arrin tek ura e fshatit Z. duke bërë vozitje në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Publik humb kontrollin ndaj automjetit dhe kalon me automjet në shiritin e kundërt të lëvizjes së tij dhe me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit e godet traktorin dhe si pasojë e saj i ka shkaktuar dëmin material dhe jo material të dëmtuarve H. M., F. M. dhe T. M., ndërsa më pastaj të njëjtit kanë parashtruar padi për kompensim demi ndaj këtu paditëses ku në atë procedurë gjyqësore këtu paditësja BKS-ja me anë të pajtimit gjyqësor të dëmtuarve të cituar më lartë u ka bërë kompensimin e dëmit në shumë prej 3,219.00 euro e cila shumë është paguar me datë 03.04.2019, e ku pas administrimit të provave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi dhe të detyrohet i padituri që në kuptim të nenit 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e

Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018, paditëses t'ia paguaj shumën prej 3,219.00 € si dhe kamatën ligjore.

Gjykata ka caktuar seancën perгатitore, e ku paditësja përmes përfaqësuesit të saj B. H., ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke propozuar që të administrohen provat sipas padisë, ndërsa në lidhje me thënjet e të autorizuarit të të paditurit në fakt përgjigjes gojore sot rreth padisë dhe atë për bazën juridike të padisë për shkak se është bazuar në Aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1/18 ku dhe është lidhur një barazim gjyqësor atëherë në mes të palëve ndërgjyqëse. Ndërsa sa i përket raportit të aksidentit edhe na në shkresat e lëndës e kemi kopjën mirëpo për këtë kërkojmë nga gjykata që të sigurohen shkresat e lëndës C.nr.1/18 dhe të njëjtat të lexohen dhe në ato shkresa mund të jetë dhe origjinali i raportit të aksidentit. Ndërsa sa i përket plotësimit të padisë precizojë ashtu që në vend të “familja Mujaj, duhet të jetë H. M. dhe F. M. së bashku me T. T. si dhe precizimi i petitumit të Aktgjykimit si në padi, ndërkaq gjatë shqyrtimeve si dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të plotësuar dhe precizuar duke i propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar mirëpo nuk i ka specifikuar.

I padituri edhe pse me kohë ka pranuar Aktvendimin për përgjigje në padi, i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në padi, ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor përmes të autorizuarit të tij av. A. R. nga Dragashi i cila ka deklaruar: Në tërësi e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse duke konsideruar se akoma nuk është krijuar baza juridike për këtë padi, nga ana e gjykatës kemi pranuar shkresat e lëndës penale P.nr. 2173/17 ku me Aktgjykim refuzohet akuza e Prokurorisë Themelore andaj nuk janë shqyrtuar dhe nuk është vendosur rreth pretendimeve të këtu të paditurit H. R. të thëna në kundërshtimin e dt. 12.10.2018 ku i njëjti ka kontestuar vërtetësinë e raporteve mjekësore duke pretenduar se vozitësi të automjetit “B” me rastin e shkakimit të aksidentit gjithashtu ka dhënë vërejtje edhe sa i përket raportit të komunikacionit, në momentin që po flasim nuk kemi njohuri se a janë trajtuar këto rrethana në procedurën kundërvajtës. Andaj rrjedhimisht është kontestuese baza juridike për paraqitjen e padisë sepse Aktvendimi C.nr.1/18 ndërmjet palëve është marrur në bazë të vullnetit të palëve dhe nuk është vendimi meritor, paditësja e merr përgjegjësitë për veprimet të cilat i ka ndërmarrur me vetëdije pa qen e obliguar nga gjykata. Sa i për këtë ekspertizave të ekspertëve në fjalë nëse na lejon gjykata vërejtjet do të paraqesim gjykatës në formë të shkruar ku gjykatës i propozojmë dëgjimin e ekspertëve kurse sa i përket ekspertizës së ekspertit B. M. nuk është përcaktuar saktësishtë përqindja e fajësisë ndërmjet palëve të përfshira në aksident, po ashtu eksperti i komunikacionit askund nuk e ka përshkruar se në rregulla të komunikacionit a është e obliguar të kompensohet dëmi i shkakuar ndaj personave të cilët kanë qenë duke udhëtuar në rimorkio – prikolicë. Meqenëse e kemi akoma në dilema se si eksperti B. M. ka ardhur deri tek konstatimi i përshkruar në raportin e tij me shkrim propozojë nga gjykata që i njëjti të ftohet edhe një herë me qëllim që të kemi mundësi ti parashtrojmë pyetjet që të mund të konstatojmë saktësinë dhe plotësishtë gjendjen faktike.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Lidhur me këtë çështje juridike gjykata ka bërë administrimin e provave, si në vijim: Bëhet leximi i raportit policor të aksidentit me nr. 2017/GR/0702 të dt. 03.09.2017, lexohet përmbajtja nga parashtrësja urdhër transferi Bankar nga kontoja – BKS – Fondi i Kompensimeve të dt. 03.04.2019 dhe pasqyra transaksioneve, lexohet përmbajtja nga konfirmimi i polisës së sigurimit të dt. 17.10.2017 TPL....., lexohet përmbajtja e padisë së dt. 27.12.2017 ku paditës është H. M. ndërsa e paditura është BKS-ja, lexohet përmbajtja e procesverbalit C.nr.1/18 ku është arritur një barazim gjyqësor atëherë në mes të paditësve H. M. etj. dhe të paditurës BKS-ja,

lexohet përmbajtja e raporteve mjekësore në emër të Faredin Mujaj të dt. 03.09.2017 lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren dhe Hajredin Mujaj me nr. të raportit 10410 të 03.09.2017 – lexohet përmbajtja nga dosja e dëmit nr. 1560/17 të dt. 03.09.2017 dhe 1558/17 e dt. 03.07.2017, kërkesa për dëmshpërblim me nr. 0001557 e dt. 17.10.2017, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit e dt. 17.10.2017 në emër të H. M., lexohet përmbajtja nga raporti mjekësor lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren – Emergjencia në emër të Tosun Trupaj me dt. 03.09.2017 me nr. protokolli 10409, leximi i përmbajtjes nga dosja e dëmit nr. 1559/17 të dt. 03.09.2017, lexohet përmbajtja e shkresave nga lënda penale P.nr.2173/2017 ndër to dhe përmbajtja e Aktgjykimit P.nr.2173/2017 të dt. 20.09.2018, si dhe përmbajtja e Aktgjykimi i dt. 31.07.2019, bëhet shiqimi dhe në foto dokumentacion. Gjithashtu në cilësi të proves personale është dëgjuar eksperti i Komunikacionit B. M. dhe eksperti mjeko-ligjor Dr. N. H.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të kujdesshëm të tyre, secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, si dhe nga konstatimi i faktete jo kontestuese në mes të palëve në procedurë, gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Nga leximi i Raportit të aksidentit të dt. 03.09.2017 me Nr. 2017-GD/0702, është vertetuar fakti se mes të paditurit H. R. nga fsh... - Komuna e Dragashit (vozitës i automjetit “A”) dhe H. M. gjithashtu nga fsh. B. - Komuna e Dragashit (vozitës i automjetit “B”), ka ndodhur aksident komunikacioni vetëm me dëme materiale, e ku këtu i padituri H. R. ka qenë i siguruar tek K.S. “S.” deri me datë 25.08.2017, që nënkupton me polisë të sigurimit të skaduar (pasi që aksidenti ka ndodhur me datë 03.09.2017), dhe se është konstatuar se vozitësi i automjetit “A” që e voziste H. R. duke mos e përshtatur shpejtësin kushteve dhe gjendjes së rrugës e ka goditur automjetin-traktorin “B” duke shkaktuar dëme materiale dhe lëndime marrin vozitësi i automjetit “B” dhe dy pasagjerë të këtij automjeti - traktori.

Nga leximi i përmbajtjes së parashtresës Urdhër transferi Bankar nga kontoja – BKS – Fondi i Kompensimeve, të dt. 03.04.2019 dhe pasqyra transaksioneve, gjykata konstaton faktin se nga rubrika 2, emri i përfituesit av. B. B. për H. M., F. M. dhe T. T. është bërë transferimi i mjeteve monetare në shumën prej 3,219.00 euro në llogarin e avokatit për ekzekutimin e barazimit gjyqësor sipas lëndës C.nr.1/18.

Nga leximi i përmbajtjes nga konfirmimi i polisës së sigurimit të dt. 17.10.2017 TPL..., gjykata ka vërtetuar faktin e validitetit të sigurimit për automjetin Ford Escort me targa..., edhe atë me validitet prej datës 25.08.2017 – 25.08.2018, e që nënkupton se kjo polisë është e anuluar me dt. 25.08.2017, që nënkupton se me rastin e aksidentit mjeti në fjalë ka qenë pa mbulesë të sigurimit.

Nga leximi i përmbajtjes së padisë së dt. 27.12.2017 ku paditës është H. M., F. M. dhe T. T. ndërsa e paditura është BKS-ja, nga gjykata provohet fakti se të njëjtit i janë drejtuar kësaj gjykate për kompensimin e dëmit të pësuar me rastin e aksidentit të trafikut të dt. 03.09.2017.

Nga lexohet përmbajtja e procesverbalit C.nr.1/18 ku është arritur një barazim gjyqësor atëherë në mes të paditësve H. M. etj. dhe të paditurës BKS-ja, gjykata ka provuar ujdin gjyqësor të lidhur mes këtu paditëses (e paditur në procesin tjetër) BKS-ja dhe të autorizuarit të paditësve H. dhe F. M. dhe T. T. – av. B. B. ku palët janë dakorduar që të lidhin pajtimin gjyqësor ashtu që paditësit H. M. ti kompensohet shuma prej ...,00 euro për të gjitha format e dëmit, paditësit F. M. ti kompensohet shuma prej ...,00 euro për të gjitha format e dëmit kurse paditësit T. T. ti kompensohet shuma prej ...,00 euro gjithashtu për të gjitha format e dëmit si dhe për dëmin material në automjet - traktor për H. M. shumën prej ...,00 euro si dhe shpenzimet e procedurës në total prej 519.00 euro apo shuma totale prej 3,219.00 euro.

Nga leximi i përmbajtjes së raporteve mjekësore në emër të F. M. të dt. 03.09.2017 lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren, gjykata provonë lëndimet e marra nga i njëjti nga aksidenti i trafikut i dt. 03.09.2017 si dhe diagnozes dhe terapisë së përshkruar.

Nga leximi i përmbajtjes së raporteve mjekësore në emër të F. M. të dt. 03.09.2017 lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren, gjykata provonë lëndimet e marra nga i njëjti nga aksidenti i trafikut i dt. 03.09.2017 si dhe diagnozes dhe terapisë së përshkruar.

Nga leximi i përmbajtjes së raporteve mjekësore në emër të T. T. të dt. 03.09.2017 lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren, gjykata provonë lëndimet e marra nga i njëjti nga aksidenti i trafikut i dt. 03.09.2017 si dhe diagnozes dhe terapisë së përshkruar.

Nga lexohimi i përmbajtjes së dosjës së dëmit nr. 1560/17 të dt. 03.09.2017 dhe 1558/17 e dt. 03.07.2017, provohet nga gjykata vlerësimi i dëmeve jomateriale për të dëmtuarit F. dhe H. M. dhe T. T. të bërë nga Komisioni i shkallës së parë të trajtimit të dëmeve nga BKS-ja.

Nga leximi i përmbajtjes së shkresave nga lënda penale P.nr.2173/2017 ndër to dhe përmbajtja e Aktgjykimit P.nr.2173/2017 të dt. 20.09.2018, si dhe përmbajtja e Aktgjykimi i dt. 31.07.2019, gjykata provonë faktin ndaj këtu të paditurit H. R. është ngritur Aktakuza PP/II.nr...-5/17 të dt. 20.11.2017 për shkak të veprës penale Rrezikim i trafiklut Publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP-së në lidhje me aksidentin e ndodhur me dt. 03.09.2017, ndërsa Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin P.nr.2173/17 të dt. 20.09.2018 të pandehurin H. R. e ka shpallur fajtor duke lëshuar Urdhër Ndëshkimor dhe duke e dënuar me gjobë në shumën prej 200 euro, ndërsa pas Kundërshtimit të bërë me dt. 12.10.2018 është zhvilluar procedura e shqyrtimit gjyqësor dhe për shkak të ndryshimit të Kodit Penal Nr.04/L-082 me Kodin e Ri Penal Nr.06/L-074 që ka hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, veprën penale të rrezikimi të trafikut publik kur kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore nuk e përcakton si vepër penale, prokurori i shtetit është tërhequr nga Aktakuza ndërsa gjykata me Aktgjykimin penal P.nr.2173/17 të dt. 31.07.2019 e ka refuzuar akuzën për faktin se Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza e kjo në kuptim të nenit 363 par. nënpar. 1.1 të KPPRK-së, ndërsa të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga dëgjimi i ekspertit të Komunikacionit B. M. gjykata provonë faktin se i njëjti në seancën e dt. 16.10.201, veç tjerash ka deklaruar: Në lidhje me ekspertizën e dt. 17.11.2017 qëndroj plotësisht pranë asaj që është thënë atë datë me të cilën citoi “deri në aksidentin në trafik ka ardhur nga pakujdesia e ngasësit të automjetit “A” Ford Eskord e z. H. R. i cili ka qen duke lëvizur në fshatin Z. në drejtim të fshatit K. dhe në të arritur tek ura e fshatit Z. në një kthesë të thellë nga ana e djathtë e drejtimit të lëvizjes nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në raport me kushtet të rrugës pasi që rruga ishte kthesë pa u siguruar paraprakisht se me këtë veprim paraqet rrezik në komunikacion, i cili gjatë procesit të lëvizjes nuk ka mundur ta përshkruaj trajektoren e lëvizjes në kthesë në mënyrë të sigurt duke kaluar në shiritin e kahjes së kundërt ku si pasoj me këndin dhe anësorin e majtë të pjesës së përparme e ka goditur automjetin “B” traktor IMT..., në rrotën e përparme të anës së majtë ku ky i fundit ishte duke lëvizur përball tij në kahje të kundërt i cili si pasoj e goditjes përfundon jashtë rruge në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes. Përparësinë e ka pas traktori sepse ai ka qen duke lëvizur në shiritin e vet të lëvizjes. Ndërsa sa i për këtë shpejtësinë nuk kemi konstatuar në mungesë të skicës nga vendi i ngjarjes. Ndërsa edhe pse i autorizuari i palës së paditur av. A. R. ka propozuar edhe një herë të dëgjohet i njëjti ekspert, edhe pse ka prezentuar në seancën e dt. 24.06.2024 mirëpo edhe pse ka propozuar

dëgjimin e ekspertit, nuk ka prezentuar në seancë dhe mungesën e vetë nuk e ka arsyetuar kurse eksperti në fjalë ka qëndruar pranë ekspertizës dhe deklaratës së dhënë me dt. 16.10.2023.

Gjithashtu në cilësi të provës personale gjykata ka marrë edhe deklaratën e ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. H. i cili në shqyrtimin kryesor të dt. 30.04.2024 ka deklaruar: Unë qëndroj mbrapa mendimit tim të dhënë në ekspertizat mjeko-ligjore të dt. 25.10.2017 për 3 të lënduarit F. M., H. M. dhe T. T., në të cilat ekspertiza jemi bazuar në bazë të raporteve mjekësore të lëshuara nga Qendra Emergjente e Spitalit Rajonal të Prizrenit me dt. 02.09.2017 me të cilat dokumenta janë përshkruar diagnozat dhe janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore për 3 të lënduarit, me pasoja të përkohshme, të cilat kanë qenë të shkaktuara nga ndonjë mjet mbretjës, kurse palët nuk kanë parashtruar kurrëfar vërejtje në lidhje me deklaratën apo ekspertizën e punuar nga i njëjti ekspert.

Nga provat e administruara Gjykata konstaton se këtu paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS). me seli ne Prishtine, është detyruar që të dëmtuarve H. M., F. M. dhe T. T., si pasojë të dëmit material dhe jo material të pësuar në aksidentin e datës 03.09.2017, aksident ky i shkaktuar me lëshimet e këtu të paditurit H. R. me kontribut primar ne shkaktimin e këtij aksidenti në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të ia paguaj shumën e tërësishme prej 3,219.00 €, që vërtetohet në bazë të ujdisë gjyqësore C.nr.1/18 te dt.05.03.2019 për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Nga dokumenti urdhër transferim i datës 03.04.2019, gjykata konstaton se të dëmtuarve H. M., F. M. dhe T. T., në xhirrollogarinë e të autorizuarit të tyre av.B. B., ju është paguar në tërësi dëmi i shkaktuar sipas këtij aksidenti, në shumën totale prej00 euro.

Baza juridike e kërkesë padisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses gjejnë mbështetje në dispozitat e nenit 9 dhe 18 te Ligjit per Sigurimin e Detyrueshëm te Auto përgjegjësisë (ligji nr.04/L-018) e lidhur me dispozitat e nenit 245 par.1, te Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 03.09.2017, në bazë të dispozitës së nenit 9 dhe 18 te Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm te Auto përgjegjësisë (ligji nr.04/L-018) ne te cilin shprehimisht parashihet se sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon ne këto raste: demet ne persona dhe pasuri te shkaktuar palëve te treta nga përdorimi i mjetit motorik , pika 1.2 demet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik, përfshinë gjithashtu demin e shkaktuar palëve te treta përmes gjësendeve te cilat bien nga mjetet motorike apo çdo gjë tjetër qe është e lidhur me mjetin motorik, pika 1.3 demet e shkaktuara nga mjeti motorik palëve te treta nga drejtuesi i paautorizuar i mjetit motorik. Gjithashtu me nenin 18.1 të po të njëjtit ligj është parashikuar se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Ndërsa neni 18.3 ka përcaktuar, citojmë: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezent në shkresat të lëndës e ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarve si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e shumës së paguar në bazë të nenit 18 par 1 dhe 3 te Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm te Auto përgjegjësisë (ligji nr.04/L-018) me te cilën dispozitë është parapare që i dëmtuari të cilit i është shkaktuar dëm nga një mjetë motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja (këtu paditësja), ndërsa më pastaj

Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës, argumente këto që përkojnë edhe me rastin që kemi objekt shqyrtimi.

Nga ana tjetër sa i përket pretendimeve dhe kundërshtimeve të palës së paditur në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë gjegjësishtë faktit të kundërshtuar në lidhje me atë se i padituri nuk është shpallur fajtorë dhe se me Aktgjykim penal është refuzuar Aktakuza ndaj të paditurit H. R., këto pretendime për gjykatën janë të pa baza për faktin se fillimishtë arsyja pse është refuzuar aktakuza ndaj të njëjtit nuk ka të bëjë me çështjen kryesore por për faktin se kemi patur në nderkohë ndryshim të Kodit Penal dhe ashtu edhe siç është cekur edhe më lartë duke zbatuar ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 të Kodit Penal Nr.06/L-074 si ligj më i favorshëm për të pandehurin, Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza, ndërsa sa i përket fajësisë rreth aksidentit, këtë çështje mjaftë qartë e ka arsyetuar eksperti i komunikacionit Burim Morina i cili kuartë ka sqaruar që fajtorë për aksidentin e datës 03.09.2017 ka qenë këtu i padituri Hafiz Rifaj, ndërsa përfaqësuesi i të paditurës edhe pse kishte propozuar që edhe njëherë të dëgjohet eksperti i komunikacionit (pasi ky kishte munguar në seancën e dt. 16.10.2023), i njëjti kishte munguar në seancën e dt. 24.05.2024 kur edhe kishte prezentuar eksperti në fjalë (për degjim pë të dyten herë). Ndërkaq në lidhje me konstatimin e lëndimeve të pësuar, eksperti mjeko-ligjor N. H. në seancën e dt. 30.04.2024 ka sqaruar mendimin e tij të dt. 25.10.2017 kurse asnjëra nga palët nuk kanë pasur kundërshtime në konstatimin e ekspertit, andaj edhe gjykata këtyre ekspertizave u fali besimin e plotë ngase janë të dhëna në mënyrë profesionale dhe brenda standardeve të profesionit të tyre.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia për rimbursimin e mjeteve të paguara në emër të sigurimit është e bazuar dhe rrjedhimisht gjykata e aprovoi atë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin material dhe jo material, gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedh për pagesë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e që në rastin konkret është kjo bazuar në nenin 170 të LMD-së, lidhur me nenin 382.2 të LMD-së.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, edhe atë bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që i padituri (i autorizuari i tij) nuk i specifikoi shpenzimet e procedurës të cilat i kërkon (shumën e tyre), si dhe nuk ofroi prova të cilat eventualisht do të dëshmonin lartësinë e këtyre shpenzimeve, ashtu siç kërkohet me nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së.

Nga e tëra që është cekur më lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:050103, 24.06.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.